



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK Nr.1, TIRANË

Nr 876 Prot

Tiranë më 06.08.2025

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”; Urdhrit nr. 1415/2 prot, me date 25.06.2025 “Për miratimin e hapjes së kursit të formimit profesional “**Shërbime Shitjeje**” në QFPP nr. 1 Tiranë”.

Ofruesi publik i AFP-së Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik nr. 1 Tiranë, Ju njofton krijimin e vendit të lire të pozicionit “**Instruktor me kohë të plotë Shërbim Shitjeje**”

I. KRITERET E PËRGJITHSHME DHE KRITERET E POSAÇME

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar
- Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- Të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesëm, në fushën/ profesionin e kursit të formimit profesional, për të cilin po aplikon;
- Të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet
- Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

II. DOKUMENTET E APLIKIMIT

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;
- Librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- -të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës

13.08.2025.

DREJTOR

HANËME MATA

